

URDHËR
Nr. 177, datë 4.6.2012

**MBI ZBATIMIN E URDHËRIT NR. 328, DATË 22.11.2011 DHE TË URDHËRIT NR. 5, DATË
9.1.2012 TË MINISTRIT TË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË
KONSUMATORIT MBI CERTIFIKATAT VETERINARE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 55 të ligjit nr. 10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 18 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”,

URDHËROJ:

1. Certifikatat veterinarë të përdorura përpara hyrjes në fuqi të urdhrit nr. 328, datë 22.11.2011 “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për certifikimin veterinar të disa lloje kafshësh dhe mishit të freskët të tyre, të cilat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nga shtete të caktuara, si dhe nga territore të tjera në administrim të këtyre shteteve”, si dhe të urdhrit nr. 5, datë 9.1.2012 “Për përditësimin e certifikatave veterinarë të cilat shoqërojnë ngarkesat e ushqimeve me origjinë shtazore, si dhe ngarkesat e ushqimeve për kafshë prodhuese të ushqimit dhe të cilat hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë”, do të lejohen të shoqërojnë ngarkesat përkatëse që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse janë lëshuar nga autoritetet kompetente jo më vonë se 20 ditë nga dita e notifikimit të urdhërave të lartpërmendur në Organizatën Botërore të Tregtisë, më datë 30.5.2012.

2. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Drejtoria e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT**
Genc Ruli